

KËRKESË
Nr. 960, datë 6.11.2025

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“ORGANIZIMI I FUSHATAVE NDËRGJEGJËSUESE PËR PUBLIKUN DHE
PËRFITUESIT, ME QËLLIM NXITJEN E NDRYSHIMIT TË SJELLJES NË LIDHJE
ME PËRDORIMIN E OBJEKTEVE SANITARE, RËNDËSINË E SHËRBIMEVE TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, SI DHE MENAXHIMIT TË
MBETJEVE TË NGURTA, PËRGJEGJËSINË E PËRDORUESVE, DUKE
PËRFSHIRË ASPEKTIN GJINOR, DHE PËR TË OPTIMIZUAR PAGESËN E
TARIFAVE”**

MARRËVESHJE KUADËR

Shteti: **Shqipëri**

Emri i Projektit: **Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu (Care4BlueSea)**

Nr. i Huas: **95070-AL**

Nr. i ID-së së Projektit: **P176163**

Titulli i detyrës: **Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për publikun dhe përfituesit, me qëllim nxitjen e ndryshimit të sjelljes në lidhje me përdorimin e objekteve sanitare, rëndësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta, përgjegjësinë e përdoruesve duke përfshirë aspektin gjinor, dhe për të optimizuar pagesën e tarifave**

Nr. reference: **AL-MTE-1.3.2-CS-QCBS**

Ministria e Mjedisit ka siguruar financim nga Banka Botërore për iniciativën Care4BlueSea dhe synon të përdorë një pjesë të këtij financimi për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë mbështetjen në hartimin dhe zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve të lidhura me to, në nivel lokal dhe kombëtar, për bashkitë target të Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (përkatësisht: Delvinë, Himarë, Finiq, Konispol, Sarandë, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet dhe Tepelenë).

Këto fushata duhet të përfshijnë udhëzime të qarta dhe të thjeshtuara, që theksojnë përfitimet dhe rreziqet, nxisin ndryshimin e qëndrimeve dhe apelimin emocional, si dhe ofrojnë rikujtime për pagesën në kohë të tarifave, në lidhje me këto shërbime. Informimi i familjeve mbi menaxhimin e duhur të mbetjeve të ngurta (SWM), ofrimi i informacionit më të mirë mbi riciklimin, theksimi i rëndësisë së higjienës dhe kushteve të mira sanitare, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për përmirësimet në sistemet e kanalizimeve dhe sanitare, do të realizohen në këtë pjesë të projektit, për një periudhë 4-vjeçare, duke filluar nga **janari 2026**.

Termat e Referencës (TOR) për fazën e parë të prokurimit për këtë detyrë janë bashkëngjitur kësaj kërkesë për shprehje interesi.

Ministria e Mjedisit fton tani firmat e kualifikuara konsulente (“Konsulentët”) të shprehin interesin e tyre për ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin informacion që demonstroi se ata zotërojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për kryerjen e Shërbimeve.

Kriteret e përzgjedhjes paraprahe janë:

NR.	KRITERE VLERËSIMI	PIKË
1.	Përvoja e përgjithshme e firmës/vitet e veprimtarisë së Konsulentit në treg	30 pikë
2.	Përvoja specifike përkatëse në fushën e detyrës dhe numri i detyrave të ngjashme me TOR-et të përfunduara me sukses	60 pikë
3.	Disponueshmëria e stafit brenda firmës për kryerjen e detyrës	10 pikë
TOTAL		100 pikë

Ekspertët (stafi i propozuar) nuk do të vlerësohen në fazën e përzgjedhjes paraprahe.

Lista paraprahe e Marrëveshjes Kuadër do të përmbajë 3 firma.

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet te seksioni III, paragrafët 3.13, 3.15 dhe 3.16 të “Rregulloreve të Prokurimit për Huamarrësit e IPF” të Bankës Botërore, të shtatorit 2025 (“Rregulloret e Prokurimit”), ku përcaktohet politika e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse bashkimi është në formën e një bashkimi të përbashkët (*joint venture*) dhe/ose nënkonsulencë. Në rast bashkimi të përbashkët, të gjithë partnerët në bashkim do të jenë përgjegjës, së bashku dhe veç e veç, për të gjithë kontratën, nëse për zgjidhen.

Një Konsulent do të për zgjidhet në përputhje me dispozitat për Marrëveshjet Kuadër të përshkruara në Rregulloret e Prokurimit dhe që do të përcaktohen posaçërisht në Kërkesën për Propozime.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni në adresën më poshtë gjatë orarit zyrtar 09:00–16:00 nga e hëna në të enjte dhe 09:00–13:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë, me faks ose me *e-mail*) deri më **25 nëntor 2025, ora 16:30, me orën lokale**.

Për më shumë informacion, Konsulentët e interesuar mund të gjejnë Termat e Referencës të bashkëngjitura.

Ministria e Mjedisit

Mjedis i Pastër dhe me Aftësi Ripërtëritëse për Detin Blu (Care4BlueSea)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

1001 Tiranë, Shqipëri

Attn: Znj. Ledina Beqiraj Agalliu

Sekretare e Përgjithshme

E-mail: ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al

Attn: Znj. Artenida Duraku

E-mail: artenida.duraku@mjedisi.gov.al

TERMAT E REFERENCËS

PËR VENDOSJEN E NJË MARRËVESHJEJE KUADËR ME KONSULENCË PËR ORGANIZIMIN E FUSHATAVE NDËRGJEGJËSUESE PËR PUBLIKUN DHE PËR FITUESIT, ME QËLLIM NXITJEN E NDRYSHIMIT TË SJELLJES NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E OBJEKTEVE SANITARE, RËNDËSINË E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, SI DHE MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA, PËRGJEGJËSINË E PËRDORUESVE, DUKE PËRFSHIRË ASPEKTIN GJINOR, DHE PËR TË OPTIMIZUAR PAGESËN E TARIFAVE PËR MJEDIS I PASTËR DHE ME AFTËSI RIPËRTËRITËSE PËR DETIN BLU
(Care4BlueSea)

1. Sfondi i Projektit

Për të mbështetur zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM) dhe për t’u siguruar që qasja rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake (MSWM) të funksionojë sa më efektivisht dhe me efikasitet sa më të lartë, Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore kanë lançuar projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu”, (Care4BlueSea). Projekti synon të zbatojë një qasje të integruar të ekonomisë blu në nivel kombëtar dhe lokal, duke u fokusuar në zona gjeografike të përzgjedhura me vlera të larta detare dhe bregdetare, të cilat janë nën presione mjedisore dhe klimatike. Care4BlueSea përbëhet nga tre komponentë:

i. Komponenti 1: Promovon qasje të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit;

ii. Komponenti 2: Synon uljen e ndotjes së ujit në lumin Vjosë; dhe

iii. Komponenti 3: Përfshin menaxhimin e projektit dhe nevojat për monitorim dhe vlerësim.

Në kuadër të nënkomponentit 1.3(a) të komponentit 1, Ministria e Mjedisit e Shqipërisë (MoE) do të financojë aktivitete të menaxhimit të njohurive dhe fushata të ndërgjegjësimit publik, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e ndryshimit të sjelljes ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara, për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të mbetjeve dhe promovimin e qëndrueshmërisë. Këto nisma do të synojnë përfituesit, shkollat, turistët sezonalë dhe publikun e gjerë, me qëllim nxitjen e ndarjes së mbetjeve në burim, kuptimin e hierarkisë së mbetjeve, përdorimin e duhur të objekteve sanitare dhe rëndësinë e menaxhimit të ujërave të ndotura.

Fushatat e ndërgjegjësimit publik do të komunikojnë përfitimet e menaxhimit të përmirësuar të mbetjeve dhe shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, duke theksuar rolin e përdoruesve, si dhe do të fokusohen në përfshirjen gjinore dhe në nxjerrjen në pah të mundësive të rikuperimit të flukseve të ndryshme të mbetjeve, për të mbështetur zhvillimin e tregut të riciklimit dhe për të ulur kostot e menaxhimit të mbetjeve bashkiake.

Më konkretisht, projekti Care4BlueSea do të mbështesë bashkitë e Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (WZ) dhe dizajni i projektit përbëhet nga tre komponentë:

Komponenti 1: Promovimi i qasjeve të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit

Ky komponent do të mbështesë zbatimin e zgjidhjeve lokale për mbrojtjen e peizazheve të vlefshme dhe burimeve të ujit brenda Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (shih hartën e WZ-së në shtojcë). Projekti aplikon një qasje të integruar për investimet në SWM, duke marrë në konsideratë parimet e ekonomisë qarkulluese dhe mbështet një sistem më të qëndrueshëm mjedisor, financiar dhe operacionalisht. Rezultatet e këtyre aktiviteteve krijojnë sinergji me ato të komponentit 2 për ujërat dhe kanalizimet. Ky komponent do të financojë shërbime konsulence, shërbime jokonsulence, mallra dhe trajnime.

Nënkomponenti 1.1: Mbështetje institucionale për performancë të qëndrueshme, monitorim të përmirësuar dhe tranzicion drejt ekonomisë qarkulluese

Ky nënkomponent synon të përmirësojë mjedisin mundësues për qëndrueshmëri operationale dhe më shumë qarkullueshmëri në menaxhimin e mbetjeve. Kjo do të arrihet përmes asistencës teknike dhe mbështetjes së kapaciteteve për mbushjen e boshllëqeve specifike teknike për zbatimin efektiv të politikave të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Do të financohen aktivitetet e mëposhtme:

i. Ofrimi i mbështetjes teknike për menaxhimin e të dhënave dhe monitorimin e performancës së menaxhimit të mbetjeve të ngurta, duke përfshirë:

a) mbështetjen për sistemet e menaxhimit dhe verifikimit të të dhënave në nivel bashkie;

b) monitorimin e performancës dhe zhvillimin e një mekanizmi zbatimi (*enforcement*) për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake; dhe

c) përmirësimin e kapaciteteve të performancës, përfshirë trajnimin, për bashkitë e pranueshme, për të siguruar mjedisin mundësues për menaxhimin dhe zbatimin e investimeve mjedisore të bazuara në performancë (EPBI), të financuara nën nënkomponentin 1.2;

ii. Kryerjen e një studimi mbi qëndrueshmërinë financiare dhe ofrimin e ngritjes së lidhur të kapaciteteve (p.sh. rikuperimi i kostove, përcaktimi dhe mbledhja e tarifave, menaxhimi i kontratave) në nivel bashkie;

iii. Mbështetje për MoE dhe bashkitë, për:

a) zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) (p.sh. mbështetje për lejet, raportim, monitorim); dhe

b) përditësimin dhe/ose zhvillimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, përfshirë standardet për materialet dhe menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit/inertëve.

Nënkomponenti 1.2: Investime të bazuara në performancë mjedisore për parandalimin e ndotjes lokale

Ky nënkomponent do të financojë EPBI-në për bashkitë në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë, për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve bashkiake. Bashkitë do të përfitojnë investime vendore kundrejt përmirësimeve të matshme dhe të qëndrueshme në grumbullimin e mbetjeve të ngurta, rritjen e riciklueshmërisë dhe/ose rikuperimit të kostove. Këto investime vendore do të mbështesin ndryshimin e sjelljes për hapësira urbane më të pastra dhe më të

gjelbra dhe ekosisteme bregdetare dhe ujore më të shëndetshme. Bashkitë do të bëhen të pranueshme për t'u përfshirë në EPBI, bazuar në performancën e tyre të mëparshme, krahas kritereve të tjera. Përshtatshmëria e bashkive, prioritarizimi dhe modalitetet e zbatimit të këtij aktiviteti janë të detajuara më tej në manualin EPBI.

Për të siguruar mjedisin e duhur mundësues për bashkitë, në mënyrë që ato të arrijnë përmirësime në performancë përmes EPBI-së, projekti do të mbështesë një sërë investimesh paraprake gjatë dy viteve të para të zbatimit. Këto do të përfshijnë: pajisje për mbështetjen e sistemit të monitorimit të bashkive; furnizimin me pajisje dhe automjete për grumbullimin e mbetjeve dhe ndarjen në burim; si dhe pajisje për qendrat e riciklimit.

Nënkomponenti 1.3: Mbështetje për ndryshimin e sjelljes dhe diseminim për shkallëzim

Ky nënkomponent do të zbatojë aktivitete të menaxhimit të njohurive (si: përgatitja dhe diseminimi i mësimave të nxjerra nga EPBI-ja për një shkallëzim të mundshëm në nivel kombëtar), fushata të rritjes së ndërgjegjësimit publik, përfshirë fushata komunikimi në shkolla mbi menaxhimin e përmirësuar të mbetjeve, ndarjen e mbetjeve, shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve dhe menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit në nivel kombëtar. Këto fushata do të informojnë mbi shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe shërbimet e ujit dhe kanalizimeve, për të mbështetur pranimin e nivelit të tarifave të lidhura me ofrimin e shërbimit. Për të mbështetur ndryshimin e sjelljes për ndarjen në burim dhe riciklimin e plastikës në zona me popullsi të lartë dhe presion turistik, projekti do të instalojë kontejnerë kompaktone diellorë (*solar compaction bins*) në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë.

Komponenti 2: Promovimi i qasjeve të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit

Ky komponent do të mbështesë aktivitete për të reduktuar ndikimet negative të ndotjes nga burime pikësore, të shkaktuara nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara dhe rrjedhjet nga ujërat e shiut, si dhe nga ndotja nga burime jopikësore (NPS), të cilat paraqesin kërcënim të rëndësishëm për ekosistemet ujore dhe mjedisin. Të gjitha investimet do të marrin në konsideratë rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike, për të siguruar qëndrueshmërinë klimatike të infrastrukturës. Ky komponent do të financojë punime ndërtimi, shërbime konsulence, shërbime jokonsulence, mallra dhe trajnime për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve, automjeteve dhe impianteve të trajtimit.

Nënkomponenti 2.1: Zgjerimi i infrastrukturës sanitare

Ky nënkomponent do të financojë investime në përmirësimin e infrastrukturës në bashki të përzgjedhura, për të përmirësuar shërbimet sanitare dhe për të reduktuar/kontrolluar ndotjen e trupave ujorë nga burime pikësore brenda Basenit të Lumit Vjosë. Janë prioritarizuar bashkitë e mëposhtme përgjatë lumit Vjosë: Përmet, Këlcyrë, Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj dhe Selenicë. Projekti do të mbështesë:

- i. ndërtimin e objekteve të përzgjedhura sanitare;
- ii. rehabilitimin, përmirësimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve;
- iii. sigurimin dhe instalimin e zgjidhjeve të decentralizuara ose *on-site* për kanalizimet (të tilla si sisteme individuale që nuk janë të lidhura me një impiant qendror të trajtimit të ujërave të ndotura);
- iv. furnizimin me pajisje operationale, përfshirë automjete vakum dhe mjete për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve;
- v. kryerjen e një vlerësimi të ndotësve dhe cilësisë së llumit; dhe
- vi. ofrimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve sanitare intra-shtëpiake (IDSI) për familjet që plotësojnë kriteret.

Projekti do të mbështesë zgjidhje teknike sanitare, në përputhje me kuadrin e paraqitur në “pemën e vendimmarrjes” së projektit (shih shtojcën 3), e cila është hartuar në vijë me Direktivën e BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (UWWTD). Projektet e detajuara inxhinierike do të hartohen në mënyrë të veçantë për çdo bashki gjatë zbatimit të projektit. Gjatë fazës së projektimit do të merren në konsideratë një kombinim i infrastrukturës “gri” dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë (NBS), duke promovuar ripërdorimin e nënprodukteve të

trajtimin të ujërave të ndotura, si llumi. Një vlerësim i ndotësve dhe cilësisë së llumit do të kryhet për të siguruar ripërdorim të sigurt dhe për të promovuar qarkullueshmërinë.

Nënkomponenti 2.2: Përmirësimi i objekteve dhe menaxhimit të kanalizimeve

Projekti do të ofrojë mbështetje për Agjencinë Kombëtare të Infrastrukturës së Ujit, Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM), Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU) dhe shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve, për zhvillimin e kuadrit institucional, politik dhe rregullator për menaxhimin e kanalizimeve dhe shërbimeve sanitare, përfshirë:

- i. kryerjen e studimeve për hartimin e një strategjie për shërbimet sanitare dhe planeve rajonale/bashkiake të ujit dhe kanalizimeve;
- ii. forcimin e planifikimit për zgjidhje të bazuara në natyrë (NBS) për reduktimin e ndotjes së ujit;
- iii. asistencë për planet rajonale/bashkiake të ujit dhe kanalizimeve dhe për agregimin/konfigurimin rajonal të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve;
- iv. trajnime për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve, automjeteve dhe impianteve të trajtimit;
- v. projektimin dhe zbatimin e një sistemi unik informacioni për monitorimin e ofrimit të shërbimeve sanitare dhe mbrojtjes së mjedisit; dhe
- vi. kontribut teknik për përditësimin e kuadrit rregullator mbi strukturën e kostove të shërbimeve sanitare.

Nënkomponenti 2.3: Parandalimi i ndotjes nga burimet jopikësore (NPS)

Projekti do të mbështesë investime në shkallë të vogël për të parandaluar rrjedhjet e lëndëve ushqyese nga bujqësia dhe depozitimin e materialit sedimentar nga erozioni në zona të përzgjedhura të Basenit të Lumit Vjosë. Nënkomponenti do të financojë zbatimin e qasjeve të zgjidhjeve të bazuar në natyrë (NBS), menaxhimit të qëndrueshëm të tokës (SLM) dhe zgjidhje të tjera të integruara në pika të përzgjedhura të basenit të lumit dhe do të përfshijë:

- i. përmirësimin e mbulesës bimore në shpatet dhe brigjet e lumit;
- ii. menaxhimin dhe restaurimin e ligatinave për të përmirësuar rrjedhën e ujit dhe për të zbutur rreziqet nga ujërat sipërfaqësore të stuhive dhe përmbytjet; dhe
- iii. mbështetjen e praktikave të qëndrueshme bujqësore.

Investimet në shkallë të vogël që promovojnë praktika të qëndrueshme bujqësore, menaxhimin e plehrave organike të bagëtitë, rigjenerimin e kullotave, plehërimin organik, kompostimin dhe praktika të përmirësuara bujqësore, do të angazhojnë fermerë dhe grupe përdoruesish lokalë nga fshatrat në pellgun ujëmbledhës të lumit Vjosë.

2. Qëllimi i detyrës

Qëllimi i kësaj detyre është të ofrojë mbështetje në hartimin dhe zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve të lidhura me to, në nivel vendor dhe kombëtar, për bashkitë e synuara të Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (përkatësisht: Delvinë, Himarë, Finiq, Konispol, Sarandë, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet dhe Tepelenë), si edhe për bashki të tjera të rëndësishme, si p.sh. kryeqytetin (Tiranën).

Këto fushata duhet të përfshijnë udhëzime të qarta dhe të thjeshtuara, që theksojnë përfitimet dhe rreziqet, nxisin ndryshimin e qëndrimeve dhe reagimeve emocionale, si dhe ofrojnë rikujtime për pagesën në kohë të tarifave të lidhura me këto shërbime. Në këtë pjesë të projektit do të realizohet edukimi i familjeve për menaxhimin e duhur të mbetjeve të ngurta bashkiake (SWM), ofrimi i informacionit më të mirë mbi riciklimin, theksimi i rëndësisë së kushteve të mira sanitare dhe higjienës, si dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi përmirësimet në sistemet e kanalizimeve dhe sanitare.

Aktivitetet për ndryshimin e sjelljes, të formësuara nga rezultatet e analizës diagnostike, do të përfshijnë fushata komunikimi dhe përshtatje të “arkitekturës së zgjedhjes” (*choice architecture*), ose një kombinim të të dyjave.

Aktivitetet e planifikuara duhet të organizohen në një mënyrë miqësore ndaj barazisë gjinore dhe modulet e trajnimit për studentët në nivel *Bachelor* dhe administratën e qeverisjes vendore do të përshtaten, për të:

- i. nxitur përfaqësim të barabartë, kontribute të barabarta dhe njohje të barabartë ndërmjet grave dhe burrave, duke filluar që në nivel shkolle;
- ii. angazhuar modele të forta frymëzuese për të inkurajuar vajzat të ndjekin studime në shkencë, inxhinieri dhe matematikë, me synimin që të avancojnë në pozicione drejtuese; dhe
- iii. promovuar procese pjesëmarrëse të ndjeshme ndaj barazisë gjinore, të cilat jo vetëm fuqizojnë gratë, por edhe rrisin ndërgjegjësimin te burrat dhe krijojnë një mjedis ku gratë dhe burrat mund të punojnë së bashku drejt objektivave të përbashkëta.

3. Përshkrimi i detyrës dhe detyrat kryesore

Shoqëritë që do të përzgjidhen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Kuadër do të ofrojnë, sipas kërkesës, shërbime komunikimi, ndërgjegjësimi dhe shërbime të lidhura me organizimin e eventeve, dhe do të mobilizohen përmes kontratave individuale *call-off*, secila me fushëveprim dhe dorëzime të përcaktuara, bazuar në aktivitete specifike.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për hartimin e përmbajtjes, përgatitjen e materialeve fizike dhe dorëzimin e të gjitha aspekteve të nënaktiviteteve brenda dhe jashtë vendit të zbatimit, në kuadër të planit të fushatës së ndërgjegjësimit, si dhe për zbatimin e tij në fushat e përmendura më poshtë, si edhe në zona të tjera të përshtatshme. Fushata do të zbatohet në 2 faza, ku faza 1 do të fokusohet në diseminimin e informacionit për të mbështetur arritjen e rezultateve të Projektit dhe faza 2 do të bazohet në konkluzionet e nxjerra nga zbatimi i fazës 1 dhe do të forcojë mesazhet fillestare, si dhe do të tërheqë vëmendjen e publikut tek arritja e rezultateve të përgjithshme të Projektit.

A. Planifikimi

- Konsulenti do të hartojë dhe paraqesë plane të detajuara për nënpëraktivitetet nën kuadrin e fushatës së madhe, sipas kërkesës dhe në koordinim me PMT-në (MoE).

- Konsulenti do të planifikojë ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve të nënkontraktimit të lidhura me prokurimin për nënpëraktivitetet e përcaktuara më sipër.

- Konsulenti do të përgatisë një plan strategjik të mesazheve për të gjitha pikat e fushatës, në përputhje me konkluzionet e nxjerra nga raporti eMBeD, i cili do t'i vihet në dispozicion pas nënshkrimit të kontratës.

- Planet do të përfshijnë dhe do të përshtaten për çdo lloj grupi specifik interesi, si në përmbajtje ashtu edhe në format dhe kanal shpërndarjeje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: nxënës dhe të rritur të të gjitha moshave, turistë sezonale, agjentë/agjenci qeveritare, biznese dhe ndërmarrje lokale të tjera, përfitues të drejtpërdrejtë dhe publikun e gjerë, nën drejtimin e ekipit të PMT-së.

- Të gjitha nënpëraktivitetet do të planifikohen duke pasur kujdes të veçantë për të gjitha aspektet e përcaktuara në tabelën 2.3, objektivat 1 dhe 2, në aneksin 2 të POM-së dhe PAD-së, që lidhen me hendekun gjinor, përfshirë hartimin e moduleve dhe trajnimeve specifike të përshtatura posaçërisht për grupin e synuar, si dhe çdo logjistikë të nevojshme për të akomoduar nevojat e veçanta të këtij grupi.

- Të gjitha aktivitetet duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara, përfshirë grupet e marginalizuara ose vulnerabël. Informacioni duhet të ofrohet në disa gjuhë dhe formate, duke marrë parasysh ndjeshmërinë kulturore.

B. Dorëzimet e pritshme

- Konsulenti është përgjegjës për zbatimin e të gjitha planeve të hartuara me mbështetjen dhe miratimin e ekipit të PMT-së.

- Konsulenti do të jetë përgjegjës për të gjitha mallrat/shërbimet e nënkontraktuara, siç janë paraqitur në planet e detajuara për secilin nënpëraktivitet, në funksion të të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

- Konsulenti do të përgatisë dhe do të dorëzojë të gjitha materialet e publikuara, sipas marrëveshjes në planet draft, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në: prezantime, reklama, materiale të printuara, materiale digjitale, përfshirë foto/video etj.

- Konsulenti do të ndërmarrë të gjithë logjistikën për secilin nënpëraktivitet, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimin me palët përkatëse të interesuara, transportin dhe akomodimin, si për stafin e vet, ashtu edhe për pjesëmarrësit në aktivitete që nuk janë me bazë në bashkitë përkatëse.

- Konsulenti do të sigurojë mbështetje në terren (*onsite*) në bashkitë përkatëse të përcaktuara më herët, si dhe në çdo vendndodhje tjetër që konsiderohet e përshtatshme nga PMT-ja, përreth dhe gjatë periudhës së planifikuar të nënpëraktiviteteve.

- Konsulenti do të përgatisë dizajne dhe skenarë të detajuar për të gjitha pikat e diskutimit në agjendën e përcaktuar në planin e detajuar të nënpëraktivitetit, të rënë dakord me ekipin e PMT-së.

Konsulenti do t'u përmbahet rreptësisht kërkesave lidhur me hendekun gjinor, siç janë përcaktuar më herët, dhe do të sigurojë dorëzimet në përputhje me to.

- Konsulenti do t'u përmbahet rreptësisht standardeve ligjore përkatëse dhe normave morale, në cilësinë e përfaqësuesit të agjencive qeveritare.

- Konsulenti do t'i vërë në dispozicion specialistit të M&V-së (M&E) të gjitha statistikatat përkatëse të eventeve dhe *feedback*-un *ex post*.

C. Aktivitete të pritshme (mund të shtohen në vijim)

- Punëtori dhe seminare – punëtori dhe seminare me komunitetin lokal mbi temat e kanalizimeve/shërbimeve sanitare dhe menaxhimit të mbetjeve, me mundësi për demonstrime dhe sesione pyetje-përgjigje bazuar në materialin e ofruar. Kjo përfshin edhe ndërhyrje specifike sipas gjinisë dhe moshës, me fokus të veçantë të gratë, si pjesë e objektivave për hendekun gjinor të Projektit, të përfshira në PAD dhe POM.

- Grupet komunitare – krijimi i grupeve komunitare (të ndara sipas gjinisë, moshës ose jo) për të promovuar praktika më të mira sanitare. Këto grupe do të dizajnohen si për të ndërtuar kapacitete vendore për të udhëhequr ndryshimin, ashtu edhe për të monitoruar dhe për të raportuar mbi gjendjen e kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve në komunitetet përkatëse të pjesëmarrësve. Brenda këtij aktiviteti, mund të zhvillohen mjete dhe platforma për të nxitur pjesëmarrjen dhe komunikimin efikas, si dhe për të adresuar ankesat përmes përdorimit të mekanizmave më të vegjël të ankesave (GRM).

- Aplikacion celular interaktiv – zhvillimi i një aplikacioni *online*, i cili mund të ofrojë në kohë reale këshilla mbi shërbimet sanitare, ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve, si dhe të integrojë mekanizmat e ankesave (GRM) dhe linja të tjera komunikimi me qytetarët dhe agjencitë qeveritare.

- Ekspozita interaktive – demonstrime dhe instalime ekspozuese që mund të vendosen në hapësira publike dhe private, me të cilat qytetarët mund të ndërveprojnë dhe që paraqesin në mënyrë të qartë përfitimet e shërbimeve sanitare dhe menaxhimit të mbetjeve.

- Diskutime në panele dhe sesione pyetje-përgjigje – organizimi i diskutimeve me panel dhe më pas i sesioneve pyetje-përgjigje ndërmjet përfaqësuesve të kualifikuar të qeverisë, aktorëve privatë apo anëtarëve të komunitetit, rreth temës së kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve.

- Shpërndarja e materialeve edukative – prodhimi dhe diseminimi i materialeve edukative digjitale dhe të printuara mbi temën e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve sanitare, për t'u shpërndarë përmes kanaleve të ndryshme, me fokus në grupe të veçanta të synuara, përfshirë burra, gra dhe fëmijë, komunitete të ndryshme lokale, individë, biznese, qytetarë privatë dhe agjentë qeveritarë.

- Fushata në rrjetet sociale, përfshirë bashkëpunimin me krijues përmbajtjeje (influencerë) – prodhimi i materialeve digjitale për përdorim në platforma të ndryshme të mediave sociale, si dhe angazhimi i individëve të njohur në këto platforma për përhapjen e materialeve të mësipërme.

- Komunikim i gjerë në media – prodhimi i materialeve rreth temës së projektit për dhe/ose pjesëmarrja në rubrika shtypi, si dhe në emisione radiofonike dhe televizive.

- Materiale të orientuara drejt ekoturizmit – fushata të synuara për turistët, duke përfshirë tabela dhe sinjalistikë shumëgjuhëshe (anglisht, frëngjisht dhe italisht), broshura dhe informacione digjitale, që promovojnë sjellje të përgjegjshme dhe pjesëmarrje aktive në përpjekjet komunitare.

- Partneritete publik-privat me bizneset – përpjekje dhe fushata të përbashkëta në bashkëpunim me, por edhe të orientuara drejt, industrisë vendore të mikpritjes dhe bizneseve të tjera të lidhura, për promovimin e praktikave më të mira të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Brenda këtij kuadri, Konsulenti do të projektojë materiale specifike mbi tematikën, për t'u

shpërndarë te, dhe përmes, bizneseve private. Përfitimet e shërbimeve sanitare dhe të menaxhimit të mbetjeve dhe stimujt e paraqitur do të shërbejnë, gjithashtu, për të nxitur pagesën në kohë të tarifave për shërbimet e sipërpërmendura.

- Fushata në shkollë – fushata të dedikuara posaçërisht për shkollat, duke përfshirë mësuesit dhe nxënësit, si fëmijë ashtu edhe të rinj, përmes materialeve që do të zhvillohen dhe shpërndahen në dhe përmes sistemit arsimor. Kjo mund të përfshijë materiale të printuara dhe digjitale, si dhe programe që do të promovohen dhe do të ofrojnë çmime për nxënësit dhe vetë shkollat që marrin pjesë aktivisht në përpjekjet publike të lidhura me temën.

- Ngritje kapacitetesh dhe optimizim tarifash për agjencitë qeveritare – trajnime për stafin e qeverisjes vendore, duke përfshirë trajnim gjithëpërfshirës mbi menaxhimin efektiv të komunikimit, zbatimit/inspektimit dhe financimit të shërbimeve të kanalizimeve dhe mbetjeve. Kjo përfshin integrimin e stimujve dhe promovimin e përfitimëve të këtyre shërbimeve, për të nxitur pagesën në kohë të tarifave.

- Konferenca në nivel bashkiak dhe kombëtar – organizimi i eventeve për shkëmbimin e njohurive, duke mbledhur së bashku aktorë të ndryshëm, përfshirë autoritetet bashkiake, përfaqësues të tjerë të qeverisë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe liderë komuniteti, për të ndarë dhe për të promovuar rezultatet e Projektit.

- Reklama/sinjalistikë e printuar – konceptimi, realizimi dhe prodhimi i materialeve të printuara që mund të ekspozohen dhe të mbeten në rajon në mënyrë të përthershme ose për periudha të zgjatura, si p.sh. bilborde, postera dhe tabela të tjera informuese.

- Evente *online* dhe transmetime *live* – digjitalizimi dhe/ose transmetimi *live* i të gjitha aktiviteteve të mësipërme, për ruajtje dhe shpërndarje nëpër kanale *online*.

4. Kualifikimet dhe eksperiencia e Konsulentit

Shoqëria konsulente duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

a) Të jetë person juridik i regjistruar, me eksperiencë si kompani marketingu dhe me shërbime të provuara në hartimin dhe zbatimin e të gjitha nënpërkaktiviteteve të përshkruara në këto ToR.

b) Të ketë realizuar me sukses minimalisht 3 fushata të gjera marketingu dhe ndërgjegjësimi, preferohet në bashkëpunim me institucione qeveritare.

c) Të demonstrojë se ka në dispozicion staf për menaxhimin e fushatave të gjera mediatike.

Shoqëria konsulente do të angazhojë ekspertët e mëposhtëm në varësi të fushës së veprimit të kontratave *call-off*. Lista specifike e ekspertëve për çdo detyrë të veçantë do të publikohet së bashku me çdo thirrje kontrate.

Tabela e ekspertëve – Marrëveshje Kuadër për Fushatat e Ndërgjegjësimi

Nr.	Pozicioni i ekspertit	Nr. i ekspertëve	Kualifikimet dhe eksperiencia	Detyrat që do të kryhen
1	Udhëheqës ekipi/ Menaxher Projekti	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Marketing, Media ose një fushë tjetër përkatëse; - Minimumi dhjetë vjet përvojë të veçantë/të kombinuara në menaxhimin e projekteve; - Minimumi tre vjet përvojë në zhvillimin e fushatave marketingu dhe ndërgjegjësimi, preferohet me fokus në çështje mjedisore dhe sociale ose agjenci qeveritare; - Eksperiencë në hartimin dhe në përgatitjen e fushatave multikanal (print dhe digjitale) me fokus angazhimin e komunitetit; - Eksperiencë në drejtimin e ekipeve me të paktën 10 persona; - Eksperiencë me institucionet	- Përgjegjës për menaxhimin e kontratës; - Caktimi i stafit dhe i detyrave të tyre specifike; - Mbajtja e komunikimit me të gjitha palët e përfshira; - Pjesëmarrja në takimet drejtuese dhe raportimi direkt tek autoritetet; - Hartimi i kuadrit kryesor për dorëzimet e nënpërkaktiviteteve; - Reagimi ndaj ndryshimeve në projekt dhe adresimi i zhvillimeve.

			qendrore shtetërore dhe Agjencitë Ndërkombëtare të Bashkëpunimit për Zhvillim, Bankën Botërore dhe IFIs; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	
2	Drejtor Kreativ	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Media, Marketing ose fushë përkatëse; - 10 vjet përvojë të veçantë/të kombinuar si ekspert i financave të projekteve; - Minimumi 5 vjet eksperiencë në zhvillimin e fushatave të gjera mediatike dhe ndërgjegjësuere, preferohet me fokus në programe qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të mbajë komunikim të drejtpërdrejtë me të gjitha zyrat përkatëse për koordinimin e aktiviteteve; - Të analizojë POM dhe PAD për të siguruar dorëzimin e aktiviteteve; - Të konceptojë dhe zhvillojë aktivitete dhe plane të detajuara, bazuar në ToR dhe sipas kërkesës së PMT-së; - Të asistojë në konceptimin dhe zhvillimin e të gjitha nënpëraktiviteve, duke përfshirë materialet digjitale dhe të printuara; - Të koordinojë dhe të udhëheqë stafin në terren për aktivitetet përkatëse.
3	Producent videoje	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Film; - 5 vjet përvojë të veçantë/të kombinuar në prodhimin e filmit; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të prodhojë dhe mbikëqyrë të gjitha materialet e regjistruara për nënpëraktivitetet; - Të sigurojë dhe menaxhojë të gjitha aspektet teknike të xhirimeve, përfshirë pajisjet audio/video, stafet, montazhin dhe procedurat përfundimtare.
4	<i>Copywriter</i> (autor teksti)	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Media, Marketing ose fushë përkatëse; - 5 vjet përvojë të veçantë/të kombinuar si <i>Copywriter</i> për kompani të fokusuara në media; - Minimumi 2 vjet eksperiencë në krijimin e përmbajtjes për agjenci qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të hartojë të gjithë materialin e shkruar, si sloganet, skenarët, titujt, tekstet reklamuese etj.; - Të koordinohet me PMT dhe specialistin e komunikimit për zhvillimin e materialeve, në mënyrë që të respektohen rreptësisht tematika dhe udhëzimet e Projektit; - Të rishikojë dhe përditësojë të gjitha materialet e shkruara që lidhen me nënpëraktivitetet përkatëse.
5	Dizajner grafik	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Media, Dizajn ose fushë përkatëse; - 5 vjet përvojë të veçantë/të kombinuar në rolin profesional, me një portofol prej X projektsh; - Minimumi 3 vjet eksperiencë në krijimin e përmbajtjes për agjenci qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të zhvillojë të gjitha grafikat dhe dizajnet vizuale për nënpëraktivitetet përkatëse; - Të koordinohet me PMT-në dhe specialistin e komunikimit për zhvillimin e materialeve, në mënyrë që të respektohen rreptësisht tematika dhe udhëzimet e Projektit.
6	Menaxher	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Media,	- Të prodhojë dhe

	prodhimi		Marketing ose fushë përkatëse; - 10 vjet përvojë individuale në prodhimin e fushatave/aktiviteteve mediatike; - Minimumi 3 vjet eksperiencë në krijimin e përmbajtjes për agjenci qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	menaxhojë të gjitha aspektet e nënpëraktiviteteve përkatëse në terren; - Të koordinohet me PMT dhe specialistin e komunikimit për zhvillimin e aktiviteteve, në mënyrë që të respektohen rreptësisht tematika dhe udhëzimet e Projektit.
7	Menaxher i rrjeteve sociale	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Media, Marketing ose fushë tjetër përkatëse; - 10 vjet përvojë individuale në prodhimin e fushatave/aktiviteteve mediatike përmes platformave të rrjeteve sociale; - Minimumi 3 vjet eksperiencë në krijimin e përmbajtjes për agjenci qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të ndihmojë në konceptimin dhe menaxhimin e fushatës në rrjetet sociale dhe të të gjitha aspekteve përkatëse, teknike ose të tjera; - Të koordinohet me PMT dhe specialistin e komunikimit për zhvillimin e aktiviteteve, në mënyrë që të respektohen rreptësisht tematika dhe udhëzimet e Projektit.
8	Analist të dhënash/ Specialist <i>Insight</i>	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Analizë të Dhënash/ Media dhe Marketing; - 10 vjet përvojë individuale në analizë të të dhënave; - Minimumi 3 vjet eksperiencë në analiza sociale/qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të mbledhë dhe analizojë të gjitha të dhënat që lidhen me fushatën dhe nënpëraktivitetet; - Të sigurojë raporte të detajuara dhe në kohë për PMT-në, specialistin e M&E dhe atë të komunikimit, duke përfshirë KPI dhe tregues të tjerë, si dhe kontekst shoqëruar dhe konkluzione që mund të nxirren nga të dhënat.
9	Zhvillues Web	1	- Diplomë <i>Bachelor</i> në Shkenca Kompjuterike / Media digjitale; - 10 vjet eksperiencë në zhvillimin e <i>web-it</i> ; - Minimumi 3 vjet eksperiencë me institucione qeveritare; - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të zhvillojë të gjithë kodin dhe produktet për faqet e <i>web-it</i> dhe aplikacionet celulare; - Të koordinohet me PMT dhe specialistin e komunikimit për zhvillimin e aktiviteteve, në mënyrë që të respektohen rreptësisht tematika dhe udhëzimet e Projektit.

Konsulenti do të angazhojë, sipas nevojës, edhe staf tjetër mbështetës në masën e duhur, me qëllim arritjen e objektivave dhe shtrirjes së kësaj detyre. Kjo përfshin ekspertë të rinj (junior) për të lehtësuar organizimin e eventeve dhe për të kryer sondazhe kur është e nevojshme.

7. Afati kontratës

